

**AKT THEMELIMI**  
**i shoqërisë "NECO 21" Sh.p.k.**

Sot, me datë 08/09/2021,

**Z. Florian Quku**, shtetas shqiptar, atësia Agron, lindur më 19/07/1985, në Shkodër, banues në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga e Barrikadave, Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. 036171091 me nr. personal. I50719060K, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "NECO 21" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "NECO 21" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Bardhok Biba", Galeria Tirana, K.1 Tirana, 1016, Tiranë.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Prodhim, tregtim, import - eksport të artikujve, pajisjeve e orendive për arredimin e brendshëm dhe të jashtëm prej xhami, çeliku, druri, materialesh plastike dhe të përbëra;



- Prodhim, tregtim, import - eksport të lëndëve të para, materialeve, mallrave të përpunuara, kimike, produkteve gjysëm të gatshme të adresuara për industrinë, artikujve të ndryshëm industrial, makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit, produkteve të nanoteknologjisë, menaxhim të Franchising;
- Shitblerje, administrim, dhënie me qira dhe nën-qira të pasurive të paluajtshme të veta dhe jo;
- Kërkim tregu, konsulenca teknike, shërbime të përfaqësimit.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 3.000.000 (tre milion) Lekë dhe përbëhet nga një 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Florian Quku**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 3.000.000 (tre milion) Lekë dhe 3.000.000 (tre milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Florian Quku**, shtetas shqiptar, lindur më 19/07/1985, në Shkodër, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. 036171091 me nr. personal. I50719060K, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar *Administratorin Z. Florian Quku* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**FLORIAN QUKU**

Florian Quku  
